


Marrëdhëniet Familje - Sckollë



Bashkë për të mirën e fëmijëve

Me shkollën, familjet ndajnë misionin e tyre kryesor mësimit dhe edukimit e rinisë. Për këtë arsye partneriteti i tyre duhet të bazohet në parimet themelore të njohura dhe të respektuara nga të gjithë. Institucioni shkollor qeveriset në radhë të parë nga Ligji shkollor i vitit 1962, nga i cili dalin tekste ligjore. Ajo është në varësi të kantonit, por komunat kanë një autonomi të gjerë. Vetë mësuesit kanë një liri të caktuar në mënyrën e vënies në praktikë të mësimit dhe edukimit.

Me qëllim që të qartësojmë një organizim, që mund të duket shumë kompleks dhe të saktësojmë detyrat dhe të drejtat e gjithësecilit, Fédération Romande des Associations de Parents d'Élèves du Valais (FRAPV) Federata Romande e Shoqatave të Prindërve të Nxënësve të Valezës, Société Pédagogique Valaisanne (SPVal) Shoqata Pedagogjike Valezane, l'Association Valaisanne des Enseignants des Cycles d'Orientation (AVECO) Shoqata Valezane e Mësuesve të Cikleve të Orientimit dhe Département de l'Économie et de la Formation (DEF) Departamenti i Ekonomisë dhe Formimit dëshirojnë të saktësojnë principet themelore me qëllim që të gjithë partnerët e shkollës të jetojnë në harmoni të plotë.

Dispozitat që ndodhen në këtë broshurë nuk zëvendësojnë tekstet në fuqi. Ato u referohen atyre dhe fiksojnë një kuadër të përgjithshëm në të cilin përfshihen marrëdhëniet mes familjeve dhe institucioneve shkollore. Autoritetet shkollore dhe mësuesit janë në gjendje të japin informacione më të plota për prindërit që i kërkojnë ato. Për më tepër, përsa u përket dispozitave të veçanta, këto janë të përkrahura dhe gjenden në faqen zyrtare të internetit të shtetit. (<https://www.vv.ch/web/se/ecole-famille>).

Me ndihmën e shërbimit të Popullsisë e të Migracionit, që merren me integrimin e migrantëve, ky botim i ri është përkthyer njëkohësisht në gjuhët më të rëndësishme të komuniteteve të huaja të pranishme në kantonin tonë. Ato mund të konsultohen në faqen e internetit të përmendur më lart.

Një njohje e mirë e gjuhës që flitet në rajonin që ju pret, është një kusht i domosdoshëm që të gjithë prindërit të jenë në gjendje të kuptojnë mirë funksionimin e institucioneve dhe të shkollës në mënyrë të veçantë.

Ne gjithashtu dëshirojmë të theksojmë rëndësinë që vendi ynë i kushton parimit të shkollimit falas, të barazisë mes vajzave e djemve ((shih konventën për të drejtat e fëmijëve, <https://urlz.fr/9L3s>) dhe domosdoshmërinë që për fëmijën, prindërit të përfshihen në mënyrë aktive në lehtësimin e marrëdhënieve Familje-Shkollë.

Shkolla e detyrueshme

Shkolla e detyrueshme zgjat 11 vjet (gradë), të quajtura HarmoS/H, organizuar në tre cikle : cikli 1 (1H - 4H), cikli 2 (5H - 8 H) dhe cikli i orientimit, 9-10-11 CO).

Shkalla e parë - CIKLI 1				Shkalla e parë - CIKLI 2				Shkalla e dytë - CIKLI 3		
1H	2H	3H	4H	5H	6H	7H	8H	9CO	10CO	11CO

Shkolla fillore

Cikli 1	1H - 2H	Dy vitet e para të shkollës (të quajtura më parë shkolla feminare) janë të detyrueshme. Moshë e hyrjes është fiksuar 4 vjeç deri më 31 korrik. Rregjistrimet duhet të dërgohen sipas udhëzimeve të komunës. Nxënësit e 1H e 2H janë në një klasë bashkë (klasë me dy nivele). Nxënësit e 1H shkojnë në shkollë gjysmën e kohës, dmth 12 periudha prej 45 minutash (16 periudha prej 45 minutash nisur prej vitit 2020), nxënësit e 2H, 24 periudha prej 45 minutash. Shpërndarja e kohës së klasës gjatë javës është kompetencë e Pushtetit lokal e mund të ndryshojë në funksion të specifikave rajonale. Gjithësesi, zakonisht parashikohen 4 paradite ose pasdite për 1H e 8 për 2H.
	3H - 4H	Koha e mësimit, si 28 periudha (périodes) 45 minutëshe, në përgjithësi bëhet për 8 paradite ose pasdite për nxënësit. Shpërndarja e gjysmës së ditës mund të ndryshojë sipas organizimit lokal.

Cikli 2	5H - 6H	Një javë mësimi llogaritet 32 periudha prej 45 minutash. Me qëllim që të mbështeten klasat me shumë nivele ose që kanë një numër të konsiderueshëm nxënësish, është e mundur të punohet për gjuhën e 2-të (gjermanisht) me grupe të ndara.
	7H - 8H	Dy klasat e fundit llogaritin po ashtu 32 periudha. Me qëllim që të mbështeten klasat me shumë nivele ose që kanë një numër të konsiderueshëm nxënësish, është e mundur të punohet me gjuhën e 2-të (gjermanisht) dhe gjuhën e 3-të (anglisht) me grupe të ndara.

Orari i ditës :

Organizimi i ditës së shkollës në orare bllok është çështje e autonomisë komunale dhe konsiston në bashkimin e periudhave mësimore në orare bllok. Ai i përmbledh periudhat e mësimin në paradite ose pasdite të plota. Në parim fillimi dhe mbarimi i gjysmës së ditës harmonizohen për të gjitha shkallët.

Numri i paraditeve ose pasditeve mund të ndryshojë në varësi të kushteve dhe nevojave lokale. Përsa u përket disa mjeteve mbështetëse të domosdoshme (transportet, UAPE etj), komunat mund të propozojnë forma të tjera organizimi të javës ose të ditës.

Cikli i orientimit (CO)


CO organizohet në 3 vjet. Kjo është një etapë që i përgatit të rinjtë për zgjedhjen e tyre profesionale. Pas CO, i riu drejtohet ose drejt një formimi profesional, ose drejt studimeve. Çdo cikël orientimi ka në dispozicion një këshilltar në formimin profesional.

CO propozon të grupojë nxënësit në varësi të rezultateve shkollë të arritura në fund të ciklit 2 (8H). Duke filluar nga 9 CO, kurset jepen në nivelin 1 ose 2 për frëngjishten dhe matematikën, pastaj nga e 10 CO, për shkencat dhe gjermanishten. Për të gjitha lëndët e tjera, nxënësit grupohen. Niveli 1 propozon mësimin zanatit më të thellë. Ekzistojnë mundësi kalimi mes niveleve, në varësi të ecurisë shkollë të nxënësit.

Principe të tjera :

- Një mësues kujdestar caktohet për çdo klasë. Ai është përgjegjësi kryesor për nxënësit dhe prindërit e klasës së tij.
- Oraret janë të përshtatura sipas planit të studimit.
- Vendi i shkollimit është vendi i banimit.
- Studime të drejtuara për një ndihmë në kryerjen e detyrave në shtëpi, organizohen nga drejtorja dhe drejtohen nga mësuesit. Këto studime bëhen jashtë kohës së mësimin dhe u propozohen nxënësve që frekuentojnë ciklin 2 e 3 (shih faqen 7 e 11).
- Mediatorët shkollë funksionojnë si persona mbështetës. Ata ndihmojnë në krijimin e një klime solidariteti dhe respekti në shkollë. Ata betohen të respektojnë sekretin profesional.

Formacione të mëtejshme



Për informacione më të plota shkoni në faqen e internetit të zyrës së orientimit shkollë e profesional (www.vs.ch/orientation).

Projekt i përgjithshëm i formimit të nxënësit në PER

« Plani i studimeve romande (PER) përcakton një projekt të përgjithshëm të formimit të nxënësit. Ai përshkruan se çfarë duhet të mësojnë nxënësit gjatë shkollimit të tyre të detyrueshëm dhe nivelet që duhet të arrijnë në mbarim të çdo cikli (në fund të vitit të 4, 8^{te} e të 11^{te}).

Plani i studimeve përbën një tërësi të njohurive dhe aftësive, zhvillimi i të cilave pritet të të gjithë nxënësit e shkollimit të detyrueshëm, të gjitha të ndara në tri drejtime :

Kapacitetet e tejprerjeme (Bashkëpunimi, Komunikimi, Strategjitë e të mësuarit, Të menduarit krijues, Mënyrat e të menduarit) ;


Formimi i përgjithshëm (MITIC, Shëndeti dhe mirëqenia, Zgjedhjet dhe projektet personale, Jetesa bashkë dhe ushtrimi i demokracisë, Ndërvartësitë) ;

Fushat disiplinore (Gjuhët, Matematika & Shkencat e natyrës, Shkencat humane dhe shoqërore, Artet, Trupi & Lëvizja).

<http://www.plandetudes.ch>

Për ta kuptuar më lehtë PER, FRAPEV shpërndan rregullisht një broshurë për prindërit dhe nxënësit që ndjekin shkollën e detyrueshme. Gjenden gjithashtu përkthime në adresën :

<https://www.vs.ch/web/se/ecole-enfantine-primaire-et-co> .



Veç nëse një diagnozë është përcaktuar nga një organ i specializuar dhe i njohur nga Departamenti i formimit, nxënësit e prekur nga vështirësi ose handikape të ndryshme (dyslexie, dysorthographie, dyscalculie, dyspraxie, HIP problematik...) mund të kenë përfitime të veçanta (kompensim i prapambetjeve) për mësim dhe kalimin e provimeve. Kujdesi për fëmijët që kanë nevojë të veçanta është organizuar sipas një mekanizmi që mund të ofrojë masa të përshtatshme për çdo rast, si më poshtë:

► Studimet e mbikëqyruara

(nga 5H deri 11CO)

Komunat mund të organizojnë studime të mbikëqyruara, jashtë kohës në klasë. Këto studime u krijojnë mundësinë nxënësve, që të kryejnë, të pavarur, krejt ose një pjesë të detyrave të tyre në shtëpi.

Nëse të gjitha komunat nuk i propozojnë në shkollën fillore, ato janë të organizuara në përgjithësi në mënyrë sistematike në CO.

► Studimet e drejtuara

(nga 5H deri 11CO)

Studimet e drejtuara u propozohen nxënësve që kanë nevojë për një ndihmë të veçantë për të kryer detyrat e shtëpisë, sidomos në lidhje me organizimin dhe strategjitë e të mësuarit. Kjo masë është e organizuar jashtë kohës së mësimit dhe e kufizuar në kohë. Në përgjithësi, kjo masë nuk është që nxënësi të arrijë t'i kryejë të gjitha detyrat në shtëpi.

► Mbështetja pedagogjike jashtë orës së mësimt

(nga 9CO në 11CO)

Nxënësi që has vështirësi kalimtare në një apo shumë disiplina me nivele ose që ka një objektiv të realizueshëm, që të përfshihet në një nivel më të lartë, mund të përfitojë mbështetje pedagogjike jashtë orës së mësimt, me qëllim që të ndihmohet që të plotësojë dëfiçitin e tij shkollor.

► Mbështetja pedagogjike për nxënësit që nuk flasin gjuhën e vendit pritës (allophones)

(në parim nga 3H në 11CO)

Mbështetja pedagogjike për nxënësit që nuk flasin gjuhën vendase, organizohet gjatë kohës së mësimt, në formën e kurseve që synojnë zhvillimin e aftësive të komunikimit të nxënësit. Kjo ndihmë e ndihmon atë të ndjekë sa më shpejt mësimin në gjuhën vendase. Kjo masë shoqëruese në parim nuk i kalon më shumë se dy vjet.

Nxënësi mund të përjashtohet nga notat për lëndët në të cilat kanë ndikim njohuritë e frengjishtes.



► Mbështetja pedagogjike e integruar

(në parim nga 3H në 11CO, me përjashtim të CO organizuar në klasa të mbikëqyrura (d'observation))

Mbështetja pedagogjike e integruar është një masë e mësimi të specializuar, e kufizuar në kohë, kushtuar nxënësve që kanë nevojë të veçanta. Një mësues i specializuar merr përsipër nxënësit në vështirësi, në klasë ose në një sallë të veçantë gjatë orëve të mësimi. Ai punon në bashkëpunim të ngushtë me mësuesin kujdestar, me prindërit dhe ndihmës të jashtëm. Balance të rregullta ndihmojnë për të analizuar progresin e arritur dhe për të përshtatur masat në varësi të nevojave të fëmijës.

► Programi i përshtatur

(nga 4H në 11CO)

Programi i përshtatur u përket nxënësve që, në një ose shumë disiplina, nuk mund të ndjekin më, pa një përshtatje të veçantë, objektivat kryesore të programit në vijim.

Krijimi i një programi të përshtatur i nënshtrohet pëlqimit të prindërve dhe autorizohet nga inspektori.

Në disa CO, nxënësit me program të përshtatur përmbledhen në klasa të mbikëqyrura.

► Përsëritja e vitit

Përsëritja e vitit është një masë për nxënësit që mbesin në klasë, domethënë që nuk i kanë mbërritur objektivat e fiksuar nga programi (mesatarja e grupit të 1-rë ose mesatarja e përgjithshme është poshtë notës 4). Kjo kërkon që të bëhet edhe një herë viti sipas programit në ciklet 2 e 3. Një përsëritje e 2H ose 3H është e mundshme në raste të jashtëzakonshme.

► Struktura të tjera mbështetëse

Zyra e mësuesve të specializuar (OES) është e aftë të informojë familjet për struktura të tjera që marrin përsipër fëmijët në vështirësi ose që janë me vështirësi mendore e fizike: klasa të veçanta, ndihmë pedagogjike e përforcuar, klasa të para-praktikës, shkolla të specializuara, shkollimi në mjedisin spitalor.

► Proçedura e vetme që duhet ndjekur në rast kërkese për ndihmë

Çdo kërkesë për ndihmë (mësimdhënie e specializuar, terapi e të folurit, psikomotricitet ose mbështetje psikologjike) duhet të depozitohet pranë drejtorisë së shkollës, përmes mësuesit, i cili do t'ju japë formularin dhe informacionet e nevojshme. Kjo kërkesë do të trajtohet më pas nga shkolla dhe disa specialistë në një seancë koordinimi. Më pas vendimi u komunikohet prindërve.



Përgjegjësia e prindërve

Prindërit:

- bashkëpunojnë me institucionin shkollor dhe repektojnë mësuesit dhe punën e tyre po ashtu edhe Rregulloren e shkollës,
- kontaktojnë mësuesin kujdestar në rast mosmarrveshjeje për të diskutuar për situatën ose për të organizuar një takim. Në varësi të situatës ose natyrës së problemit, drejtoria ose në disa raste inspektori do të informohen,
- mbajnë përgjegjësi për praninë e fëmijëve të tyre në shkollë në kushte të mira të të mësuarit (higjiena, mirësjellja, fjetja),
- duhet të interesohen për sjelljet dhe punën e fëmijëve të tyre në klasë dhe të përfshihen për këtë në shtëpi me dashamirësi,
- duhet të marrin pjesë në takimet për të cilat thirren nga mësuesit/drejtoria. Në rast nevojë, prania një përkthyesi/interpreti është e nevojshme,
- njihen me informacionet e dhëna nga shkolla dhe e vërtetojnë këtë, nëse kërkohet, nëpërmjet nënshkrimit të tyre, për më tepër kërkojnë informacione në rast nevojë,
- janë përgjegjës për fëmijët e tyre në rrugë dhe në oborrin e shkollës, jashtë orarit të mësimi (siguri, sjellje, telefona celulare),
- lajmërojnë mësuesit për problemet e mundshme shëndetësore të fëmijës që mund të kenë një rëndësi në marrjen e tij përsipër,
- sigurojnë fëmijën e vet kundër rrezikut të sëmundjeve dhe aksidenteve. Pra nuk ka sigurim shkollor kolektiv, në rast aksidenti, prindërit i drejtohen kompanisë së tyre të sigurimit,
- kanë detyrimin të lajmërojnë në shkollë çdo mungesë dhe ta justifikojnë atë,
- janë të lutur ta respektojnë në mënyrë rigorozë planin shkollor. Në rast mashtrimi, inspektori mund të vendosë gjoba,
- janë përgjegjës për pushimet që kërkojnë dhe mbajnë përgjegjësi për ndjekjen e programit në bashkëpunim me mësuesit,
- mund të thirren për një pjesëmarrje financiare për kampet shkollore me zgjedhje,
- njoftojnë shkollën për ndërrimin e adresës sa më shpejt që të jetë e mundur,
- evitohet përdorimi i rrjeteve sociale për rregullimin e problemeve shkollore dhe favorizojnë një takim me mësuesin.

Prindi që nuk e ka autoritetin prindëror do të informohet për ngjarje të veçanta në jetën e shkollore të fëmijës dhe do të dëgjohet para se të merren vendime të rëndësishme për zhvillimin e tij. Ai mund të marrë nga palët e treta, të përfshira në kujdesin e tij, informacione të rëndësishme mbi gjendjen e tij të zhvillimit.



Përgjegjësia e nxënësve

Nxënësit, me ndihmën e prindërve të tyre dhe të mësuesve :

- respektojnë rregullat e shkollës, mësuesit, personat që punojnë në shkollë dhe shokët e tyre dhe gjithashtu, gjithçka që është vënë në dispozicionin e tyre (lokalet, mobiljet, materialet),
- kanë një veshje të pastër dhe të pranueshme të përcaktuar nga rregullorja e shkollës,
- zbatojnë dhe përfshihen në rolin e tyre të nxënësit, po ashtu në të mësuarit e të jetuarit në shoqëri,
- janë të ndaluara përdorimi i materialeve elektronike për qëllime private në oborrin e shkollës. Jashtë territorit të shkollës, nxënësit duhet të mbajnë një qëndrim korrekt dhe respekt për shokët e tyre të shkollës dhe personelin e shkollës, veçanërisht në përdorimin e rrjeteve sociale (mosha minimale mes 13 e 16 vjeç sipas rrjeteve),
- mosrespektimi i rregullave është i dënueshëm.

Përgjegjësia e shkollës dhe e mësuesve

Shkolla :

- është e përkushtuar të nxisë pjesëmarrjen dhe përfshirjen e nxënësve në mjedisin shkollor dhe u jep atyre të drejtën të japin mendimin e tyre dhe të dëgjojnë.

Mësuesit :

- marrin përsipër të ndihmojnë prindërit në detyrën e tyre të edukimit dhe mësimit, duke e respektuar nxënësin dhe prindërit e tij dhe duke u përkujdesur për këtë me drejtësi e paanësi,
- ndihmojnë në socializimin e fëmijës dhe integrimin e tij në klasë,
- duhet të informojnë të gjithë prindërit për shkollimin e fëmijës së tyre, të paraqesin objektivat pedagogjike nëpërmjet mbledhjes së prindërve në tërësi dhe takimeve individuale. Në rast nevojë, prania e një përkthyesi/interpreti është e nevojshme,
- komunikojnë rregullisht rezultatet e arritura nëpërmjet një dosjeje vlerësimi, librezës shkollore dhe përmbledhjes së vlerësimeve dhe informojnë prindërit për aktivitetet kulturore, sportive, shpirtërore dhe parandaluese,
- janë në dëgjim të prindërve, përqipen të ruajnë dialogun dhe, me takim, u përgjigjen, kërkesave të prindërve,
- janë përgjegjës për disiplinën në klasën e tyre dhe ndërhyjnë, nëse është e nevojshme në oborrin e shkollës, edhe për nxënësit e tjerë të shkollës. Në rast nevojë, ata marrin masa disiplinore të parashikuara sipas rregullores,
- janë përgjegjës për zhvendosjet e tyre dhe aktivitetet gjatë orëve të mësimit. Prindërit janë përgjegjës për zhvendosjet individuale të fëmijëve (në raste të veçanta, vizitë mjekësore, etj).




Detyrat e shtëpisë

- Detyrat e shtëpisë mund të përmbajnë detyra ose mësimet që synojnë zhvillimin e autonomisë së fëmijës duke përfunduar njohuritë e përfituara në shkollë dhe për të ruajtur kontaktin dhe bashkëpunimin me familjet.
- Në një masë të arsyeshme, ato duhet të përshtaten sipas moshës së fëmijëve dhe të mund të realizohen në mënyrë të pavarur.
- Roli i familjeve është që të krijojnë dhe të kujdesen për një mjedis për fëmijën që ai të mund t'i bëjë detyrat e tij në shtëpi, të tregojnë ineteres për aktivitetet e tij dhe të kontrollojnë detyrat e bëra, pa i korigjuar ato sistematikisht. Prindërit i raportojnë mësuesit vështirësitë më të rëndësishme të konstatuara (kohëzgjatja, sasia, vështirësia, etj).
- Sipas mendimit të mësuesit kujdestar dhe të drejtorit, studimet e drejtuara mund të organizohen për nevoja të njohura.

Proçedura në rast konflikti

- Në çdo situatë, dialogu duhet të jetë i privilegjuar.
- Bashkëbiseduesi i parë për prindërit është mësuesi ose mësuesi kujdestar. Pas tij mund të kërkohet ndihma e drejtorit e pastaj e inspektorit.
- Për të gjitha vështirësitë e hasura në shkollë mes nxënësve, prindërve, tutorëve ose të tretëve me personelin mësimdhënës, drejtoria merr vendim të prerë. Vendimi i saj mund të shqyrtohet nga inspektori shkollor.




Shëndeti në shkollë

Shëndeti në shkollë Nga një këndvështrim komunitar, misioni i shëndetit në shkollë është të sigurojë promovimin, parandalimin dhe mbrojtjen e shëndetit të nxënësve.

Infermierja mban lidhjen mes shkollës dhe prindërve, në rast problemi shëndetësor të fëmijës apo adoleshentit. Prindërit dhe mësuesit mund të kërkojnë këshilla dhe informacione.

Trajtimi me pjesëmarrje



Për më shumë informacione : <https://www.promotionsantevalais.ch/fr/sante-scolaire-460.html>.

Rruga për në shkollë

Rruga për në shkollë Zhvendosjet në rrugën për në shkollë janë nën përgjegjësinë e prindërve. Janë të privileguara udhëtimet në këmbë. Siguria, shëndeti dhe lëvizshmëria duhet të respektohen dhe të vlerësohen gjatë gjithë kohës.

Pédibus (ecja në këmbë e një grupi fëmijësh nën drejtimin e një të rrituri) përbën një alternativë shumë interesante. Në varësi të mundësisë së njerëzve, çdo pedibus qarkullon me frekuencën e nevojshme (vajtje/ardhje, vetëm vajtje, disa ditë në javë, etj)

Për më shumë informacione : valais@pedibus.ch ou 076 690 51 68.

Biçikleta dhe trotineta duhet t'i përshtaten masës trupore të fëmijëve dhe të jenë të pajisura si duhet. Përdorimi i tyre duhet të respektojë rregullat e qarkullimit rrugor dhe të policisë (rekomandohet mbajtja e kaskës).

Në rastin e disa aktiviteteve të veçanta, mësuesi ose prindërit mund të transportojnë nxënësit në makina private, me kusht që ata të jenë të siguruar kundër aksidenteve dhe që të respektohen rregullat e qarkullimit rrugor : mbajtja e fëmijës nga një pajisje e përshtatshme, numri i fëmijëve të mos kalojë numrin e vendeve të autorizuara në lejen e qarkullimit, etj.

Komunat mund të lëshojnë direktiva më të kufizuara. Duhet t'u referoheni atyre.

Strukturat e pritjes

Pritja e fëmijëve, jashtë familjes, gjatë ditës u krijon mundësi prindërve të pajtojnë jetën profesionale dhe familjare dhe u ofron fëmijëve që nga lindja deri në fund të shkollës fillore, mundësinë që të mirëpritën në kolektiv në një strukturë ditore që favorizon zhvillimin e mirë dhe mbështetjen e fëmijës në mësimet e tij ose privilegjon një pritje më familjare te prindërit gjatë ditës.

Llojet e ndryshme të strukturave të pritjes janë si më poshtë :

- Çerdhe bebesh : që nga lindja deri në 18 muaj, hapur gjithë ditën, me ushqim,
- Çerdhe : nga 18 muaj deri në 6 vjeç, hapur gjithë ditën, me ushqim,
- Kopësht : nga 18 muaj deri në 6 vjeç, hapur paradite ose pasdite, pa ushqim,
- Njësi pritëse për nxënësit e shkollës (UAPE) : nga 4 vjeç deri në fund të shkollës fillore, hapur jashtë kohës së mësimet, me ushqim,
- Kopsht fëmijësh : nga 3 deri në 6 vjeç, hapur gjysmë-dite, pa ushqim,
- Vend-ruajtjeje : nga 2 deri në 8 vjeç, hapur gjysmë-dite, pa rezervim për disa orë, pa ushqim.

Strukturat e krijuara nga komunat janë subjekt i autorizimit dhe mbikëqyrjes nga kantoni.

Për më shumë informacione : <https://www.vs.ch/web/scj/secteur-d-accueil-a-la-journee>.

Federata Romande e Shoqatës së Prindërve dhe Nxënësve në Valais Romand
www.frapev.ch

Shoqata Pedagogjike Valezane
www.spval.ch

Shoqata Valezane e Mësuesve të Cikleve të Orientimit
www.aveco.ch

Shërbimi i mësimdhënies
www.vs.ch/web/se

Zyra e mësimdhënies së specializuar
<http://www.vs.ch/web/oes>

Qendra Informacion-komunikacion-teknologji
<https://www.ictvs.ch>

Plani i Studimeve Romane prezantuar prindërve
<https://www.vs.ch/web/se/ecole-enfantine-primaire-et-co>

Plani i studimeve romane
<http://www.plandetudes.ch>

Orientimi shkollor e profesional
www.vs.ch/orientation

Shërbimi kantonal i rinisë
www.vs.ch/web/scj

Projekti Edukimi jep forcë
www.vs.ch/web/scj/edf

Shëndeti shkollor
<https://www.promotionsantevalais.ch/fr/sante-scolaire-460.html>


Strukturat e pritjes
<https://www.vs.ch/web/scj/secteur-d-accueil-a-la-journee>

Bruga për në shkollë
<https://pedibus.ch/coordinations/pedibus-valais/>

Broshura Marrëdhëniet Familje-Shkollë
<https://www.vs.ch/web/se/ecole-famille>

Për informacione më të veçanta dhe lokale, drejtoju drejtorisë së shkollës ose referojuni faqes së internetit të shkollës, po ashtu edhe agjendës shkollë.

EDUQUER, C'EST...



...beaucoup d'amour



...accepter le conflit



...savoir écouter



...mettre des limites



...amener à l'autonomie



...montrer ses sentiments



...prendre le temps



...encourager



www.vs.ch/web/scj/edf